

Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1052/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Drin Veselajt anetar i AAK-se, kandidat për kuvend komunal të Komunes së Pejes, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve pas publikimit të rezultateve përfundimtare për anetar të kuvendit komunal për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor dhe Manipulimit të votave, në seancën e panelit të mbajtur më 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Drin Veselajt kandidat për kuvend komunal të Pejes, nga rrjedhet e AAK-se dega në Pejë

Arsyetim

PZAP-i, më datë 03.12.2013 ka pranuar një ankesë nga Drin Veselajt anetar i subjektit politik Aleanca për Ardhmerinë e Kosovës (AAK), konkretisht kandidat për asamble komunale të Komunes së Pejes në të cilën pretendon se duke u bazuar në informatat e vëzhguesve dhe në FRP ka dyshime që ka ndodhur ndonjë gabim teknik ku sipas FRP në disa vendvotime ka pasur me shumë vota se sa sipas KQZ-se. Në V.V 1703C/02-FPR-1 sipas KQZ-se 0. Në V.V 1704C/06R-sipas FRP-13, sipas KQZ 12. Në V.V 1704Y/03R- sipas FRP-2 sipas KQZ 0. Në V.V 1706C/05R-sipas FRP-2 sipas KQZ 1. Në V.V 1709C/02R-sipas FRP-1 sipas KQZ 0. Në V.V 1712C/02R-sipas FRP-1 sipas KQZ 0. Në V.V.1727C/01R-sipas FRP-4 sipas KQZ 3. Duke u bazuar në elektoratin e kandidatit në fjalë dyshon që në keto qendra iu është mohuar vota :1714C,1709C,1708C,1713C dhe si kandidat për asamble komunale me nr 32 kërkon të shqyrtohet ankesa nga KQZ-ja sepse pas publikimit të rezultateve ka mbetur jashtë asamblese komunale për 4 vota kurse sipas FRP ka 7 vota me shumë gjithsejt 448.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:


Ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi nga dëshmitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës se pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës nuk qendrojnë prandaj vlerësohen si të pabazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse, andaj ankesa e tillë është e pabazuar dhe se për këtë çështje PZAP-i në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe dhe nenit 3.6.pika c. vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1052/2013 më datën 06.12.2013

Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani



Këshillë Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*